



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË –DEGA PODUJEVË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-GRANAK U PODUJEVU-BASIC COURT OF
PRISTINA-BRANCH IN PODUJEVO

C.nr.1151/2020
Datë:28.10.2020
P o d u j e v ë

Në bazë të nenit 83 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, kërkojmë që të publikoni këtë:

SHPLLJE

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Podujevë, në çështjen kontestimore të paditësit-propozuesi Lutfi Isuf Beselica nga Podujeva rruga “Skënderbeu” të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij Hasan Përvetica avokat nga Podujeva, kundër të paditurve-kundërshtarët e sigurimit Biljana (Branko) Millojeviq, Slavica (Branko) Millojeviq, Slavko (Branko) Millojeviq dhe Zorica (Branko) Millojeviq që të gjithë nga Podujeva me vendbanim të pa njohur diku në Serbi, **Vërtetim Pronësie**, në bazë të nenit 79.1, të LPK-së, të paditurve: Biljana (Branko) Millojeviq, Slavica (Branko) Millojeviq, Slavko (Branko) Millojeviq dhe Zorica (Branko) Millojeviq që të gjithë nga Podujeva me vendbanim të pa njohur diku në Serbi, **me aktvendimin C.nr.1151/2020 të dt.28.10.2020**, në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm i ka caktuar Muharrem Sadiku, avokat nga Podujeva, i cili do ta përfaqësojë të paditurin, në këtë çështje kontestimore, deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqitet në këtë gjykatë.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
C.nr.1151/2020 më dt.28.10.2020



Gjyqtari :
Nazmi Neziri

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil, si gjykatë civile e shkallës së parë me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Nazmi Neziri dhe sekretaren juridike-procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridiko civile të paditësit-propozuesit Lutfi Isuf Beselica nga Podujeva rruga “Skënderbeu” të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij Hasan Përvetica avokat nga Podujeva, kundër të paditurve-kundërshtarët e sigurimit Biljana (Branko) Millojeviq, Slavica (Branko) Millojeviq, Slavko (Branko) Millojeviq dhe Zorica (Branko) Millojeviq që të gjithë nga Podujeva me vendbanim të pa njohur diku në Serbi, për Vërtetim Pronësie në bazë të posedimit **në vlerë prej 82.000€uro**, duke vendosur sipas propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në shqyrtimin përgatitorë më datë 28.10.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

Caktohet si përfaqësues i përkohshëm Muharrem Sadiku, avokat nga Podujeva, për të paditurit-kundërshtarët e sigurimit Biljana (Branko) Millojeviq, Slavica (Branko) Millojeviq, Slavko (Branko) Millojeviq dhe Zorica (Branko) Millojeviq që të gjithë nga Podujeva me vendbanim të pa njohur diku në Serbi. Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të publikohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një nga gazetatat e shtypit ditor në Kosovë, dhe një kopje i dërgohet Qendrës për Punë Sociale në Podujevë.

A r s y e t i m

Të paditurit-kundërshtarët e sigurimit Biljana (Branko) Millojeviq, Slavica (Branko) Millojeviq, Slavko (Branko) Millojeviq dhe Zorica (Branko) Millojeviq që të gjithë nga Podujeva me vendbanim të pa njohur diku në Serbi, ndërsa nuk ka përfaqësues të autorizuar, andaj i autorizuari i paditësit Hasan Përvetica avokat në seancën e shqyrtimit përgatitorë të mbajtur pranë kësaj gjykate ka propozuar që të njëjtëve të u caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë të saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga e gjitha kjo u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 79.1, 81.1 dhe 83 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
C.nr.1151/2020 më dt.28.10.2020

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.



Gjyqtari :
Nazmi Neziri